

DEKORACIONE TË GURTA NË KULLËN MATJANE MOTIVE ATDHETARE, TË TRIMËRISË DHE MIKPRITJES

MSH. Artan KURTI
Akademia "Rrënjët Tona"

PËRMBLEDHJE

Studimi i banesës popullore, në fshatin dhe qytetin shqiptar vazhdimisht ka qenë prioritet për t'u studiuar nga institutet shkencore shqiptare, si dhe nga individë-studiuues të huaj e vendas, nga rangjet akademike deri në nivel lokal. Kulla e Matit, si banesë e mbarë popullsisë së kësaj krahine, ka tërhequr vëmendjen për arkitekturën dhe mjedisin ekonomik e shoqëror të saj. Për sa i takon dekoracioneve të përdorura në mjediset e jashtme e të brendshme të kësaj banese, ka pak studime, ku vlejnjë për t'u përmendur studiuesi Dilaver Kurti me publikimin e një studimi me titull "Zbukurimorja e Matit" dhe Akademik Mark Tirta, i cili i është referuar dekoracioneve të përdorura në banesën popullore të Matit në funksion të studimeve mbi etnologjinë dhe mitologjinë e shqiptarëve.

Fjalë kyce: dekoracion, gurë, kullë, trimëri, mikpritje

ABSTRACT

The study of the popular dwelling in the Albanian village and town has always been a priority to be studied by the Albanian scientific institutes, as well as by foreign and local individuals-researchers, from the academic ranks to the local level. Kulla e Matit, as the residence of the entire population of this province, has attracted attention for its architecture and economic and social environment. Regarding the decorations used in the exterior and interior of this apartment, there are few studies, where it is worth mentioning the researcher Dilaver Kurti with the publication of a study entitled "Matte Decoration" (1) and Academic Mark Tirta, who referred to the decorations used in the popular dwelling of Mat in the function of studies on the ethnology and mythology of the Albanians.

Key words: decoration, stones, tower, bravery, hospitality

HYRJE

Krahina e Matit bën pjesë në Shqipërinë e Veriut. Me ndarjet e sotme administrative ajo përbëhet nga dy bashki: Bashkia Mat (në veri të krahinës) dhe Bashkia Klos (në jug). Në aspektin e shtrirjes gjeografike mbarëshqiptare, ajo ndodhet në qendër të trojeve etnike. E gjithë krahina kufizohet me këto bashki: në veri me Mirditën, lindje me Dibërën, lindje e juglindje me Bulqizën, jug e jugperëndim me Tiranën dhe në perëndim me Krujën dhe Kurbinin.

BANESA POPULLORE NË KRAHINËN E MATIT DHE LLOJET E SAJ

Krahina malësore e Matit, pavarësisht ndikimeve të kulturave të ardhura nga pushtues të ndryshëm, ka ruajtur etnitetin dhe kulturën vijuese iliro-arbëroro-shqiptare. Kjo vihet re jo vetëm në gjuhë dhe folklor, por edhe në veshjet, mënyrën e jetesës dhe, sidomos, në ndërtimin e banesës për strehim familjar etj. Banesa e popullsisë së krahinës së Matit, është ajo e tipit kullë, mbizotërues i banesës fshatare dhe ka historinë e vet të zhvillimit në aspektin teknik, arkitektonik dhe dekorativ. E ndërtuar kryesisht në pika dominuese, në kodra dhe shpate malesh, që ndihmojnë për mbrojtjen nga faktorë të ndryshëm natyrorë, agresionet e pushtuesve dhe hasmëritë, ajo përbëhet nga mjedise, ku kanë gjetur zbatim teknikat e ndërtimitarisë, të cilat mbartin pasuri të çmuara të artit popullor të gdhendjes në gur dhe dru. Në përgjithësi banesa popullore e tipit kullë është e thjeshtë, modeste për sa i përket

përmasave dhe e kufizuar për sa i përket funksionit të mjediseve. Ajo i përket të gjitha shtresave të popullsisë dhe sipas studimeve të bëra ndahet në katër tipe kryesore:

1. Kulla tip kala, për shtresat sunduese, “oxhaqet”.
2. Kulla me sharapot i përket kryesisht shtëpive “të para”.
3. Kullë e thjeshtë, për mbarë shtresën e fshatarësisë: dy, tre dhe katërkatëshe.
4. Kullë me dy hyrje, evoluim i shek. XIX-XX, kohë kur rriten kërkesat për jetesë më të mirë dhe mjedisi i jetës njerëzore ndahet nga ai i bagëtive.

Në ndërtimin e një kulle kanë ndikuar shumë faktorë, që e kanë bërë arkitekturën e saj të jetë në



funkcion të jetës familjare, duke siguruar elemente të fortifikimit, por edhe të dekorimit. Arkitektura popullore e pasqyruar në krijimtarinë ndërtimore të banesës së tipit kullë, shpreh ndikimin jo vetëm të komponentëve fiziko-gjeografikë, por, para së gjithash, ndikimin e faktorëve shoqërorë dhe ekonomik, si në stilin e banesës ashtu edhe në mënyrën e shfrytëzimit të saj.

Fig. - 1 Kullë trekatëshe. Fshati Derjan

Në këtë kontekst shohim gjithashtu evoluimin dhe tipat e banesave, pasurimin e traditës në përputhje me këto kushte. Ndërtimtaria e pasqyruar në banesën popullore të krahinës së Matit, në përshtatjen e saj për banim ka krijuar jo vetëm tipologjinë lokale të zhvilluar nga faktorët e lartpërmendur, por edhe ndikimeve të zonave me të cilat kufizohej dhe kishte marrëdhënie miqësore e tregtare. E tillë ishte pjesa jugore e krahinës së Matit. Jo rrallë herë në fshatin Guri i Bardhë dhe në zonën e Klosit hasen ndërtime me ngjasime të banesës qytetare dhe asaj me telize të huazuar nga krahinat fqinje, ku kryenin shkëmbime tregëtare. Kjo mund të vinte për shkak se kufizoheshin me Malësinë e Tiranës dhe Çermenikën, por edhe se ndërtuesit në disa raste vinin nga këto zona. Nuk përjashtohet mundësia që banorët të kenë parë të këto molele praktikitetin në funksionimin e jetës së tyre familjare, apo kështu i orientonte pozita gjeografike malore dhe e kishin përvetësuar si model



banese. Elementet me ngjashmëri në zonat e mësipërme vihen re në banesa që sot kanë statusin “Monument Kulture”, siç janë në Klos Katund “Hani i Allushit”, “Hani i Lleshit” banesa e vëllazërisë Domi në Gurë të Bardhë(10) dhe të gjitha banesat e fshatit Guri i Bardhë, përveç asaj të vëllazërisë Dezhgiu, që është e tipit kullë.

Fig. - 2 Dera hyrëse e banesës së një familje të besimit katolik me kryqin dhe hënën. Fshati Kokërdhok

Arkitektura e jashtme e banesës dhe dekorimi i saj

Krahas anës funksionale dhe fortifikimit për të siguruar jetën e anëtarëve të familjes, banesa ka pasur edhe elementët e saj dekorativë të zburimores. Dekoracionet e aplikuar në gdhendjet e banesës popullore të krahinës së Matit janë të lidhur pazgjidhshmërisht me arkitekturën e saj. Sasia e ngarkesës dekorative dhe përmbajtja e tyre

kanë qenë të varur nga forca ekonomike e pronarit, pa përjashtuar këtu edhe ndikimin e mjeshtrave ndërtues nëpërmjet aftësive të tyre realizuese. Banesat ndërtoheshin me gurë që kishte zona, por për pjesët që luanin rol dekorues mund të merreshin edhe më larg, në vende ku dilnin gurë të favorshëm për skalitje, siç ishte guri i kuq, guri i bardhë dhe ato me përbërje shtufore. Blloqet që do të gdhendeshin, shkëputeshin nga trupi i shkëmbit me pyka e qysqi të ndryshme dhe pasi kalonin një përpunim paraprak afroheshin pranë banesës, ku i nënshtroheshin latimeve të imta. Në gdhendjet e përdorura në pjesë të ndryshme të banesës popullore të krahinës së Matit, si në gur ashtu dhe në dru, ka mbisunduar stili gjeometrik i gdhendjes.

Ky stil nga ana teknike dhe pasuria dekorative ruan elementë të hershëm tradicionalë. Motivet gjeometrike në të shumtën e rasteve janë përdorur në enët dhe mjetet e drunjtja, si lugët, krëhërat, furkat, musandrat,(12) ndërsa në gur, janë përdorur të gërshetuara me motive floreale apo shtazore, duke u vendosur shpeshherë si kornizime të sipërfaqeve të gdhendura. Krahas këtij stili, ka funksionuar edhe ai me motive floreale, që kryesisht është përdorur në ballet e oxhakëve apo tavanet e odave të miqve, por edhe në qemerët e portave.



Simbolika e përdorur në gdhendjet e banesës popullore të Matit është e pasur. Këtu hasen motive të tilla si: dielli, hëna, shqiponja, hardhija, gjarpëri, kali, dora etj.

Fig. - 3 Dera hyrëse e banesës së një familje të besimit islam me hënë me yll. Fshati Macukull

Në shumë raste, ndërthurur me elementët e sipërpërmendur, hasim simbole religjioni, si kryqin dhe hënë me yll, elemente paganë diellin, pemën e jetës, të cilët i gjejmë kryesisht në ballet e oxhakëve dhe dyert e avllive dhe të banesës.(13) Shumica e mjeshtrave që kanë ushtruar zëjen e gdhendjeve në gur dhe dru të banesës matjane, janë vendas,(14) pasi Mati ka patur shkollën e vet të gdhendjes. Por, në mungesë të një qendre qytetare, ajo mbeti në shkallën e ushtrimit të një zeje fshatare(15) brenda ekonomisë familjare, fshatit apo krahinës. Ka edhe raste kur mjeshtrit ndërtues dhe gdhendës vinin nga Golloborda, Çermenika, Mirdita, ose ishin nga sllavët e Maqedonisë së Veriut. Ata sollën risi për sa i takon teknikave të ndërtimit, por iu kërkuar të përdorin si model në ndërtimet e reja banesën e tipit kullë. Në këtë mënyrë, edhe zbukurimorja e kullave ka shërbyer si shëmbëlltyrë dhe model për ndërtimet e reja nga koha në kohë.



Fig. - 4 Dera hyrëse e një banese me mbishkrim dhe motive të ndryshme. Fshati Shulbatër

Duke gjurmuar banesën popullore matjane, mjediset jetësore dhe traditën e zbukurimores në Mat, kemi konstatuar se ornamentika e përdorur në dekorimin e sipërfaqeve kryesore të kësaj banese ka simbolikë të frymëzuar nga flora dhe fauna e mjedisit krahinor, duke ruajtur elementë të trashëguar të heraldikës dhe simbolikës kombëtare, si edhe elementë të huazuar të simbolikës kozmogonike dhe me karakter fetar të përdorur edhe në popuj të tjerë. Gdhendjet në gur janë zbatuar në pjesët e dukshme dhe funksionale të banesës. Një e tillë ishte porta e avllisë dhe ajo e

banesës. Porta është konsideruar si kult i mbrojtjes, mbarësipturëse dhe prodhimtare, ndaj “është marrë me të mirë”, duke e zbukuruar me motive të kulteve të ndryshme dhe dekoracione me trajtesa artistike. Në qemerin, apo arkitraun e saj, gjejmë simbole të kultit të diellit, mikpritjes, vijimësisë së jetës, shqiponjën dykrenore, dorën, hënën etj. Në shpatullat (kolonat) anësore të portës larmia e motiveve është më e pasur. Këtu gjejmë formula fetare e simbole mitike mbrojtëse, shkrime informative mbi pronarin dhe mjeshtrin ndërtues, dekoracione gjeometrike, motive me origjinë pagane, bestytni për largimin e syrit të keq, simbole fetare, figura antropomorfe, simbolin kombëtar-shqiponjën dykrenare dhe figura të tjera zoomorfe etj. Në kolonat e portave nuk mungojnë edhe simbole të mikpritjes: ibriku i kafes. Elemente që shprehin karakterin luftarak dhe trimërinë, si shpata, pushka apo revolja. Mjaft i përhapur është dekorimi floreal, sidomos rozetat, që në kuptimin bazë përfaqësojnë diellin, siç janë rozetat me gjashtë, tetë apo dymbëdhjetë petale, të cilat simbolizojnë përçimin e rrezeve. Shpesh këto motive në portë kompozohen brenda kornizave me forma katërkëndëshe, rombike, apo rrethore, ku shprehet ndërthurja e stilit gjeometrik me atë kompozicional. Dekorimet e përdorura me motive gjeometrike dhe ato floreale shpeshherë i gjejmë të ngjashme me stolitë dhe pjesë të veshjeve popullore. Një paralelizëm i tillë ekziston në qemerin e portës, i cili ngjason me “shaminë rrokull” (shamia e kokës e grave të fshatit Macukull) të zonës së Prellit. Për mënyrën e mbajtjes dhe dekorimit të kësaj shamie etnologia Afërdita Onuzi është shprehur se ajo ngjan me një diademë të bërë prej pëlhure pambuku.(16) Parë në këtë kontekst këto lloj dekoracionesh të portës i shohim të përfaqësojnë grafikisht dhe në mënyrë skematike madhështinë e saj, si kult i mikpritjes, duke e paraqitur si “portë qiellore” me diellin dhe yjet apo si kurorë mbretërore shoqëruar me rozeta në formë stolishë.

MOTIVE ATDHETARE DHE PATRIOTIKE NË DEKORACIONET NË GUR

Në morinë e motiveve me origjinë nga bota bimore e shtazore, që përfaqësojnë kulte e mite të periudhave pagane, si dhe motivet gjeometrike, stilizime estetike të kulturave iliro-arbërore, gjejmë edhe motive të tjera me përmbajtje atdhetare dhe patriotike. Këto motive kanë bashkudhëtuar në jetën e banorit të krahinës së Matit dhe janë ngurtësuar në banesën e tij duke e ruajtur identitetin krahinor dhe kombëtar. Shqiponja dykrenare është motivi më i përdorur në portat dhe ballet e oxhakëve. Në motivet patriotike bëjnë pjesë një sërë dekoracionesh, që pasqyrojnë figura mashkullore me armë në dorë: pushkë apo revole, ose gdhendje që pasqyrojnë vetëm armët siç janë shpatat, pushkët, revolet etj.

Motivi i shqiponjës në hyrje të banesës dhe në ballet e oxhakëve



Fig. – 5, 6 Motivi i shqiponjës në derën hyrëse të banesës - Fshati Karicë dhe Zenisht Megjithëse në krahinën e Matit ka gjurmë të ekzistencës së banesës tip-kullë qysh në shek. XVI(17) dhe janë ende funksionale kulla të ndërtuara në gjysmën e dytë të shekullit XIX.



Fig. - 7 Motivi i shqiponjës në dollapët anës oxhakut - Fshati Shulbatër.

Duke u nisur nga mbishkrimet dhe duke e marrë të mirëqenë se datimet e gdhendura aty përputhen me kohën e ndërtimit të banesës, motivin e shqiponjës në banesën popullore të krahinës së Matit e hasim në fillim të shek. XX. Atë e gjejmë krahas ornamentikës dekorative dhe simbolike me përmbajtje pagane apo të religjioneve. Po t'i referohemi kohës para Rilindjes, motivi i shqiponjës është ruajtur në veshjen e gruas, siç është motivi i gunës,(18) por në gdhendjet dekorative të banesës ato rivijnë në dhjetëvjeçarin e dytë të shek. XX, kur u çelën edhe shkollat e para shqipe në krahinën e Matit. Nga kjo kohë mbishkrimet filluan të shkruhen në shqip dhe krahas elementëve të trashëguar të ornamentikës floreale dhe zoomorfe, simboleve të religjioneve; si gjysëm hëna me yll, kryqi etj, fillon të gdhendet simboli kombëtar: shqiponja dykrenare. Si element i heraldikës ajo është provuar nga studjes të ndryshëm që është shumë e hershme në trojet shqiptare.

Motivi i shqiponjës është i vendosur në vendet kryesore të banesës: në qendër të harkut të qemerit, apo të arkitraut të portës hyrëse dhe në ballet e oxhakëve. Ajo shfaqet herë e vetme dhe herë e shoqëruar me ornamente gjeometrikë, florealë dhe të simbolikës kozmogonike. Shpeshherë e kemi hasur brendashkruar një formati katror që mendojmë se simbolizon flamurin. Në këto raste ajo shoqërohet me tekstin: “RROFTË FLAMURI” ose me inicialet “RR. FL.”. Në ndonjë rast edhe “RROFTË SHQIPNI” (Shqipëria). Në bazë të një renditje kronologjike të materialit të grumbulluar, motivin më të vjetër të shqiponjës e gjetëm në një nga kullat e vëllazërisë Sulkurti në fshatin Prëll, e cila mban vitin 1926. Ajo është gdhendur në mermer të kuq të marrë në Malin e Shën Mërisë, mbi fshatin Lis dhe për shkak të fortësisë së materialit nuk është arritur të gdhenden detaje të arrira. Për nga teknika është relief i dystë me sipërfaqen e gurit, gdhendur me thellim të siluetit.

Fig. - 8 Motivi i shqiponjës në derën hyrëse të banesës së vëllazërisë Sulkurti. Fshati Prëll.



Këtu paraqitet shqiponja dykrenare me krahë të hapur me pendët poshtë, si shqiponja në stemën e Kastriotëve dhe vulën e Skënderbeut dhe nuk i ngjan shqiponjës së flamurit kombëtar të ngritur në Vlorë, katërmëdhjetë vite para së të ndërtohej kulla. Është për t'u hulumtuar më tej në se ky motiv është gdhendur njëkohësisht me ndërtimin e banesës, apo gurët janë huazuar nga ndonjë ndërtim i mëparshëm. Fakti që në mes dy kokave të shqiponjës ndodhet një yll pesëcepësh dhe jo gjashtëcepësh, përsëri shtyn për të studiuar zhvillimin historik të këtij simboli.

Motivet e tjerë të shqiponjës në hyrjet e banesës popullore të Matit, janë të periudhave më të vona, me ngjashmëri me shqiponjën e flamurit të ngritur më 28 nëntor 1912 në Vlorë dhe të ngjashme me modelet pasardhëse deri në ditët tona. Të tilla kemi gjetur në fshatrat Prëll, Baz, Fushë Baz, Barbullëj, Macukull, Dukagjin të Matit, Batër të Vogël, Lis, Shulbatër, Shëlli, Burrel etj. Në shumë prej këtyre

rasteve shqiponjën e gjejmë pa yll sipër edhe pse (nisur nga datimet) këto janë realizuar në vitet 50-60 deri fillimvitet '70 të shek. XX, kur ylli ishte në flamurin kombëtar, sipër shqiponjës. Shqiponjën e hasim dendësisht edhe në ballet e oxhakëve. Oxhaku ose vatra e zjarrit, që në kuptimin figurativ personifikon vatrën familjare, ishte vendi ku mblidheshin rreth tij familjarët për t'u ngrohur, gatuar, për të pritur mikun dhe pjekur kafen.



Fig. – 9, 10 Motivi i shqiponjës pa yll - Fshati Burrel dhe Karicë

Ai vendosej në një nga muret perimetrale të banesës për arsye konstruktive e funksionale të daljes së tymit dhe në pjesën më të dukshme të “Odës së burrave”, që ndryshe quhej dhe “Oda e miqve”. Kjo odë ishte krenaria e mikpritjes, prandaj duhej të kishte ngarkesë figurative në orenditë e pakta prej druri dhe në ballet e oxhakëve. Oxhaku, ku janë aplikuar dekoracionet popullore, është quajtur *model frëng*, në kuptimin model i ardhur nga kultura europiane. Elementët e tij, kryesisht, gdhendeshin në gur shtufi, që është material që nuk thyhet nga zjarri dhe i butë për tu punuar. Kështu, edhe ngarkesa dekorative e kompozicionale dhe cilësia e gdhendjes së motiveve janë shpeshherë më të saktë se ato të përdorura në portën hyrëse të banesës, ku janë përdorur gurë gëlqerorë apo mermer i kuq. Historia e zhvillimit të dekoracioneve të ballit të oxhakit është e njëjtë me atë të shqiponjës së punuar në hyrjen e banesës popullore të Matit, në vitet 20-30 të shekullit XX.(24)



Fig. - 11 Motivi i shqiponjës në ballin e oxhakit të banesës së Sulë Likursit - Fshati Gurrë e Madhe.

Shqiponjën si element qëndror e kemi hasur jo vetëm në dekoracionet e ballit të oxhakit, por edhe në dekoracione anash tij. Motivin e shqiponjës të përdorur në ballet e oxhakëve, në bazë të datimeve të shkruara

aty, e gjejmë të realizuar në vitin 1941 në banesën katërkatëshe të Sulë Likursit, në Gurrë të Madhe. Aty paraqitet shqiponja me krahë të hapur, vizatim jo shumë i saktë, shoqëruar me simbole të tjera, emrin e pronarit dhe vitin e ndërtimit. Me të vërtetë në këtë rast, apo edhe në raste të tjera nuk janë dhënë detaje dalluese, por nëpërmjet ndjenjave dhe shijeve estetike kanë arritur të gdhendin ornamente që kanë vënë në dukje funksionalitetin e objektit të zbukuruar.(25)

Motivet e tjera të shqiponjës janë me yllin, si simbol i ideologjisë komuniste, apo brenda stemës së republikës të para viteve '90. Këto janë realizuar në fund të viteve '50 e në vazhdim.




Fig. – 12, 13 Motivi i shqiponjës me yll. Fshati German dhe Shulbater

Kemi dhe raste kur motivi i shqiponjës, brenda stemës së republikës, është pranë simboleve të huaja siç është hëna me yllin-simbol vendeve islamike Përrjashtim nga shqiponjat me përmbajtje të ideologjisë komuniste është një oxhak në fshatin Bel të Klosit, ku shqiponjën e gjetëm të përfshirë në stemën e monarkisë shqiptare, ndërkohë që ndërtimi shënon vitin 1958 dhe një rast tjetër në fshatin Bushkash, ku përsëri ishte gdhendur stema e monarkisë shqiptare. Duke iu referuar kohës së ndërtimit të banesës, ky oxhak është realizuar gjatë viteve '70 të shek XX.



Fig. - 14 Motivi i shqiponjës në stemën e Monarkisë Shqiptare, fshati Bushkash

Nga materiali i mbledhur në terren, shqiponja si motiv në dekoracionet e banesës popullore të Matit, zë një vend të dukshëm dhe të rëndësishëm të dekorimit të mjedisit, ku zhvilloi aktet e jetës së tij banori matjan. Megjithëse motivi i shqiponjës dhe heraldika shqiptare ka ekzistuar qysh në mesjetë, në Mat pati një ndërprerje të gjatë për tu rikthyer pas lëvizjes së Rilindjes Kombëtare dhe shpalljes së Pavarësisë e deri në ditët tona, duke pësuar

ndryshime në interpretim nga ndikimet politike dhe ideologjike. Pavarësisht nga përmbajtjet e politizuara dhe të pa preferuara për kohën, banorët vazhdojnë t'i ruajnë, edhe si relike të paraardhësve të tyre. Rruga e gjatë që ka bërë ajo duket edhe në punimet që vazhdojnë të realizohen në disa fshatra, ku gdhendësit vazhdojnë të ruajnë shqiponjën si simbol kombëtar duke përsosur realizimin artistik dhe formën kompozicionale.

Motive të figurës njerëzore dhe armëve

Krahas motiveve të tjera në dekoracionet e aplikuara në banesën popullore të Matit, në disa raste shohim të trajtuar figurën e njeriut. Në këto raste trajtohet figura mashkullore, e cila personifikon të zotin e shtëpisë apo paraardhësin e familjes së asaj banese, të paraqitur me shpatë dhe armë në dorë,

për të treguar burrërinë e trimërinë. Ky personazh paraqitet i hipur në kalë, por edhe me cigarishte në dorë për të treguar sjelljet burrërore dhe shkallën dhe pozitën shoqërore.

Megjithëse për realizimin anatomik dhe detajet artistike ka vend për vërejtje, mjeshtërit kanë arritur të shprehin simbolikën që ato mbartin. Në derën hyrëse të banesës së Xheladin Canit në fshatin Macukull, kemi hasur në gdhendje me motive të ndryshme, të cilat kanë qenë objekt studimi edhe nga etnologu Mark Tirta. Dera e kësaj banese është ndër më të dekoruarat në Macukull. Ajo është e pasur me simbole kultike e mesazhe të tjera informuese, të realizuara në gur të kuq. Në qendër të harkut të qemerit ndodhet e gdhendur në relief figura e një burri me një shpatë në dorën e djathtë dhe një revolver në dorën e majtë. Të dyja këto armë u janë drejtuar dy gjarpërinjve, të cilët u janë sulur dy shpendëve, që në këtë rast mendojmë se personifikojnë pëllumbin, pra paqen dhe mirësinë. Kështu, veprimi i kësaj figure mashkullore, tregon ashpërsinë ndaj të keqes dhe njëkohësisht drejtësinë dhe mirësinë.



Në një banesë vëllazërisë Midha në fshatin Burgajet, pjesët formuese të portës dhe përreth saj, janë realizuar në blloqe guri prej shtufi rënor. Ekspozimi i tyre ndaj agjentëve atmosferikë ka bërë që të dëmtohen rëndë detajet e sipërfaqeve të gdhendura, por në disa raste ende janë të dukshme dekoracionet më aktorë njerëz, kafshë, simbole kozmogonike e mbishkrime, motive floreale etj.

Fig. - 16 Figurë burri i gdhendur në portën e avllisë. Fshati Vinjollë

Në gdhendjet e kësaj banese, të gjinisë së relievit, kemi ndeshur për herë të parë një figurë të njeriut hipur në kalë. Relievi është mjaft i dëmtuar dhe me një trajtim të varfër artistik, por në 'të duket klorësi, që me dorën e majtë mban frerin, ndërsa me dorën e djathtë është duke qëlluar me revolver një kafshë që ndodhet përballë tij. Këtu kemi të bëjmë me një kompozim, i cili, mbase, paraqet një skenë gjahu. Te njëra nga portat e avllive të vëllazërisë Valteri në fshatin Vinjollë (Mat), krahas motiveve të tjera, në anën e djathtë të saj kemi fotografuar figurën e një burri me një pushkë në dorën e djathtë dhe një cigarishte në dorën e majtë. Përsëri figurën e burrit në qëndrimin në këmbë me pushkën të mbajtur me dorën e djathtë dhe me qytën të mbështetur në tokë, e kemi hasur në një banesë të vëllazërisë Kolaveri në Macukull. Në të gjitha rastet figurat antropomorfe janë të gdhendura në anën e djathtë të portave ose mbi qemerët e saj. Mendojmë se me realizimin e këtyre figurave, mjeshtërit dhe pororsitësit, duan të tregojnë trimërinë dhe qëndresën atdhetare të banorëve.



Në kuadrin e transmetimit të mesazhit të simbolikës së trimërisë së banorëve të një banese janë edhe prania e motivit të armëve, siç janë shpatat dhe armët e zjarrit. Në afërsi të portës apo në qoshtet e gdhendura të banesës kemi ndeshur me motivin e shpatës, të paraqitur me një hark të lehtë në formën e



jataganit. Kjo dëshmon për realizime të hershme, kur shpata ishte në përdorim, por nuk duhet të shmangim dhe simbolikën që ka fituar ajo në kohë. Në fshatin Gurrë e Vogël kemi gjetur të gdhendur në qoshet e një banese të vëllazërisë Hajdini shpatën dhe revolverin dhe kjo mendojmë se është gdhendur për të shprehur vijimësinë e qënies shtëpi me trashëgimi luftarake brez pas brezi. Ndërsa vetëm shpatën e kemi ndeshur te vëllazëria Muharremi në lagjen Pepaj të fshatit Gurrë e Madhe, vëllazëria Hoxha në fshatin Rrëmull, vëllazëria Bushi në fshatin Dukagjin dhe në fshatin Shëlli te një nga dyert e banesës së vëllazërisë Mata.

Fig. - 15 Motive armësh. Fshati Gurrë e Vogël

Armët e zjarrit janë të pranishme në dekoracionet e përdorura në banesën popullore në Mat, si në dorën e një figure mashkullore si veçmas në kolonat anësore të portave dhe qosheve të gdhendura të banesës. Në një nga banesat e vëllazërisë Sulkurti në fshatin Prëll (Mat) në blloqet e kolonave të portës janë gdhendur pushka dhe revolveri. Në anën e djathtë të portës së vëllazërisë Shira në fshatin Karicë është e gdhendur figura e një burri me një revolver në dorë drejtuar një gjarpëri që po sulmon një gjel. Krahas këtyre motiveve, në kohëra të caktuara kemi dhe gdhendje simbolesh politike, që tregojnë ndikimet e tyre në jetën e kohës. Nisur nga të dhënat historike Mati ka qenë një krahinë, që i ka rezistuar ndikimit të kulturave të pushtuesve dhe ka ruajtur identitetin e popullit shqiptar të këtyre anëve. Në motivet e gdhendura në banesën popullore të krahinës së Matit nuk kemi hasur aq shumë në simbole që janë sjellë nga pushtuesit dhe kulturat e tyre, qoftë romakët e lashtë, qoftë sllavët e mesjetës. Kjo edhe për shkak se të dhënat historike tregojnë se ata nuk arritën të vendosen në territorin e krahinës së Matit. Tendanca e politizimit të dekoracioneve vihet re në ndërtimet e periudhave të vetëqeverisjes së shqiptarëve, sidomos e periudhës së monarkisë shqiptare 1928-1938. Në banesën e vëllazërisë Almeta, në Burrel, thuhet se në arkitraun e katit të dytë ka qenë e shkruar “Rroftë Zogu i Parë, mbreti i shqiptarëve”(28) Më të shumta simbolet politike janë të viteve ‘50-‘60 të shek. XX. Në motivet e kësaj periudhe, shqiponjën dykrenare, e hasim me yllin pesëcepësh në krye. Ky simbol gjendet në qemerët dhe arkitrarët e portave dhe në ballet e oxhakëve e të dollapëve anash tij. Motiv tjetër i periudhës komuniste është stema e republikës së shpallur më 1946-n. Atë e gjejmë të gdhendur në qendër të arkitraut, shoqëruar me figura gjeometrike, mbishkrim me emrin e pronarit, mjeshtërit ndërtues dhe në ballet e disa oxhakëve.

MOTIVE TË MIKPRITJES

Përveç hapësirave ku familja zhvillonte procesin jetësor, banesa kishte dhe mjedis të posaçëm në funksion të mikpritjes. Kjo ishte “sanksionuar” edhe në ligjet e të drejtës zakonore mbarëshqiptare “*Shpija e shqyptarit është e Zotit dhe e mikut*”.(29) Mikpritja konsiderohej ndihmë dhe përkrahje shoqërore e detyrueshme në vështrimin moral,(30) prandaj fshatari përgatitej për të prituri miq të ftuar për gëzime familjare dhe miq të rëndësishëm që kalojnë rrallë apo një herë në jetë. Kështu, sado i varfër të ishte fshatari matjan, ashtu si në traditën mbarëshqiptare, mendohej të respektonte me mikpritjen e tij çdo udhëtar a mik. Kjo bëhej sipas normave shoqërore, duke ndarë me ‘to mjedisin jetësor dhe ushqimet, *me çfarë i ka dhanë Zoti*, në një hapësirë të posaçme, të pastër dhe rregulluar me oxhak për t’u ngrohur. Ardhjen e një mikut të pa prituri i zoti i shtëpisë e pret me çfarë ushqimesh ka në familje, por edhe mikut është i kënaqur që gjeti një strehim për të kaluar natën.(31) Elemente të mikpritjes janë pasqyruar në dekoracionet e gdhendura nga mjeshtërit ndërtues si në pjesët e jashtme të banesës, ashtu edhe në brendinë e saj. Kryesisht ato i gjejmë të shprehura nëpërmjet motivit të pëllëmbës së dorës, apo dy duarve të shtrënguara dhe takëmet e kafesë, duhanit etj.

Motivi i dorës

Duart kanë luajtur rol të rëndësishëm në historinë e njerëzimit. Që nga kohët e lashta ata ishin gjymtyrët që morën pjesë direkt në evoluimin e jetës njerëzore nëpërmjet punës dhe prodhimit të produkteve jetësore, por edhe janë përfshirë në demonstrimin e forcës për të siguruar ushqimin nëpërmjet gjuetisë, si dhe në simbol të pushtetit. Sot e kësaj dite thuhet: “E shtiu në dorë pushtetin”, “Është në dorë të zotit”, “Është dorë e fortë”, etj. Në evoluimin e jetës njerëzore dora ka qenë pjesë e ritualit miqësor të kontaktit, duke e vënë krah për krah në supin e personit që takon, duke e kapur në



parakrah apo duke shtrënguar pëllëmbët. Dora vihet në zemër për të treguar seriozitetin e realizimit të çështjes, e vendosim mbi një libër të shenjtë të religjionit për të treguar para Zotit vërtetësinë dhe besueshmërinë e fjalës së dhënë.

Fig. - 17 Motive të mikpritjes - Fshati Fushë Baz (Baz)

që kërkon strehë në atë banesë. Por dora është aty edhe si simbol i pronësisë së banesës. Etnologë të ndryshëm kanë publikuar ilustrime të gdhendjeve të një dore në funksion të mesazhit të përfaqësimit të besës që afrojnë banorët e asaj banese, si dhe dy duarve të lidhura, duke uruar mirëseardhjen dhe bujarinë. Në portat e shtëpive në qytete “takllima” ishte një objekt në formën e një dore metalike me të cilën trokiste i ardhuri. Gjatë gjurmimeve në terren kemi mundur të fotografojmë raste të përdorimit të motivit të dorës si dekoracion dhe me qëllim funksional. Në Fushë-Baz të fshatit Baz, në banesën e Kolë Gjetë Gjinit, në fasadën e së cilës ndodhen dy porta hyrëse, kemi fotografuar dy duar të shtrëngyara, të gdhendura në relief mbi njërin nga portat.



Fig. - 18 Motive të mikpritjes. Fshati Dukagjin (Mat)

Poshtë duarve janë dhe simbole të tjerë si shqiponja mbi harkun e qemerit që lidhet me qenien patriotë të banorëve, dy pëllumba të cilët simbolizojnë dhe qenien të lirë e paqësor të tyre, si dhe dy kryqe në skajet e jashtme të portave. Në banesën e Allaman Dedjes, në fshatin Dukagjin të Matit, motivi i dorës është pasqyruar në formën e një pëllëmbë me gishta të hapur gdhendur në kulmin e qemerit të portës hyrëse, e cila sipas interpretimeve të mëparshme tregon dorën e të parit të shtëpisë që pret me bujari dhe besë. Mbi ‘të në një sfond katror qëndron e gdhendur shqiponja dykrenare, duke

plotësuar idenë se besa dhe mikpritja janë të lidhura me patriotizmin e kësaj familje. Në të njëjtin vizatim ndodhet dhe një dorë e gdhendur me siluet në lartësinë e mesme të anës së djathtë të portës së banesës së Selman Vatës në fshatin Macukull. Banesa e Xhelal Barçit në fshatin Frankth është një ndërthurje midis banesës së tipit kullë me elemente të banesës qytetare.



Fig. - 19 Motive të mikpritjes. Fshati Frankt

Fasada e saj me strukturë druri përfshin gjithë lartësinë në formë ballkonesh nga kati i parë deri tek i treti, të cilët shërbejnë edhe për ngjitje me shkallë druri. Në anën e majtë të portës së katit të tretë, ndeshëm një dorë në miniaturë të punuar në hekur të rrahur nga kovaçi, që luante rolin e gremçit ku vareshin rroba, shkopa apo armët e mikut. Gishtat e hapur dhe të përthyer lart

ndihmojnë në mbajtjen e sendeve që varen dhe tregon dorën e shtrirë për mikpritjen e mikut. Rast tjetër është një dorë që mban një çelës dere, gdhendur në një nga dyert e banesave të vëllazërisë Valteri në lagjen “Farric” të fshatit Lis.

Fig. – 20 Motive të mikpritjes. Fshati Lis

Takëmet me simbolikë mikpritjen të trajtuara në gdhendjet e portave të banesave



Mikpritja është traditë e banorëve të fshatrave të Matit, ashtu si te mbarë shqiptarët. Pjesë e rëndësishme e mikpritjes ishte qerasja e mikut, ku më simboliket ishin qerasja me kafe dhe cigare duhani. Gjatë momenteve të respektimit të mikut me rëndësi ishin edhe takëmet, instrumentat që shërbenin për të realizuar qerasjet gjatë mikpritjes.

Te këto takëme bënin pjesë ato ku përgatitej e shërbehej kafëja, të cilat në të folmet e zonave të Matit emërtohen “*rraçet e kâfes*”, apo “*veglat e kâfes*”. Takëmet e kafesë ishin më “luksozet” në inventarin e enëve të një familje dhe përdroreshin e ruheshin vetëm nga i zoti i shtëpisë, i cili shpeshherë kujdesej edhe për larjen e tyre në një lavaman të vogël, në qosh të oxhakut, aty ku ishte vendi i uljes së tij. Roli i përdorimit të takëmeve të tilla dhe simbolika që kishin ata në aspektin e mikpritjes, ishte bërë shkak që kjo simbolikë të ngurtësohej edhe në dekoracionet e gdhendura në portën e banesës. Ibrikët e kafësë dhe kutia e duhanit ishin instrumenta që simbolizonin mikpritjen dhe bujarinë e të zotit të shtëpisë. Krahas tyre edhe gjymi i ujit është simbolikë e mikpritjes dhe higjenës familjare, që i afrohet mikut nga amvisat e kësaj familjeje.

Në një nga banesat e vëllazërisë Sulkurti në fshatin Prëll, krahas revoles dhe hënës me yll, ndodhet dhe një masë drejtkëndore në relief, që paraqet kutinë e duhanit, e cila simbolizon mikpritjen. Në portën e avllisë së vëllazërisë Valteri në fshatin Vinjollë, siç kemi thënë, gjendet figura e një burri me qëndrim në këmbë, i cili mban pushkën në dorën e djathtë dhe një cigarishte në dorën e majtë. Cigarishtja (një çibuk i gjatë me cigare) është element burrërie për kohën dhe simbolizon mikpritjen. Në kollonën e djathtë të portës së banesës së Xheladin Canit në fshatin Macukull kemi rastin e një gruaje me ibrik në dorën e djathtë, ndërsa në banesën e Rustem Kryekurtit, po në Macukull, në boshllikun e majtë të portës vërehet një gjym (ibrik). Këto dekoracione janë të rëndësishëm për mesazhin që përçojnë dhe simbolikën e mikpritjes që ata mbartin prandaj ndërtuesi dhe gurëskalitësi

kanë preferuar t'i vendosin në elemente të rëndësishëm të portës, e cila sipas bestytive tregon mbarësi.

PËRFUNDIME

1. Kohërat dhe etapat e ndryshme historike e shoqërore, ku ka kaluar populli shqiptar, kanë ndikuar në mënyrën e jetesës së tij, duke krijuar tipologji të ndryshme të banesës popullore, sipas faktorëve ekonomikë, politikë dhe shoqërorë, por dhe sipas vendndodhjes së tyre në fshat apo në qytet.
2. Krijimtaria popullore në fushën e arkitekturës, nëpërmjet punës së mjeshtrave ndërtues, na ka lënë trashëgim shumëllojshmëri të banesave sipas krahinave, grupimeve etnografike, relievit, pozitës gjeografike, ekzistencës në qytet apo në fshat etj.
3. Edhe në krahinën e Matit banesa popullore dhe tipet e saj kanë kaluar nëpër etapa zhvillimi të ndryshme. Mbisunduese dhe më e preferuara ka qenë ajo e modelit të tipit kullë e huazuar nga fortifikimet mesjetare dhe banesa e klasës sunduese. Te kjo lloj banese dhe më pas edhe llojet e tjera, përveç rëndësisë që kishin: funksionimin e jetës familjare dhe fortifikimin për ruajtjen nga agresione të ndryshme, ndërtuesit i kushtonin vëmendje të veçantë dhe elementëve zbukurimorë, dekorativ dhe simbolik, në vendet më të dukshme dhe më të rëndësishme të arkitekturës së saj.
4. Këto elementë gdhendeshin kryesisht në gurët e latuar në hyrje të banesës, në ballet e oxhakëve, në drurët e dollapëve, musandrave, trapazanëve, tavanëve etj. Ato bëheshin me qëllim zbukurimor dhe shprehnin botëkuptimin e banorëve të saj në lidhje me bestytinë dhe mitet, që i kanë shoqëruar gjatë zhvillimit shoqëror. Ngarkesa sasiore e këtyre dekoracioneve varej nga pozita shoqërore apo gjendja ekonomike e pronarit të banesës.
5. Gdhendjet në gur i hasim në qemerët dhe kollonat anësore të dyerve të kullave, apo portikëve në rastin e avllive, por edhe në ballet e oxhakëve të odave të e burrave. Ndërsa gdhendjen e drurit e hasim në dollapët e kàfës, sheshenat dhe te tavanet, kryesisht në odat e burrave.
6. Gurët e latuar të portave përmbajnë ornamente të stilit më të hershëm, atij gjeometrik dhe më pas atij floreal, ku herë-herë ka tentativa për krijim emblemash, që shkasin në simbole të përgjithëshme dhe të huazuara, siç janë kompozime ku përfshihen figura e njeriut, motive kozmogonike: dielli, hëna dhe yjet, motive zoomorfe, si shqiponja, pëllumbi, gjeli, gjarpëri, dashi, demi, kali etj, motive të armëve, si shpata, pushka dhe revolveri, veglave të punës së mjeshtrave ndërtues, si çekiçi dhe mistria etj, por edhe simbole të kohës së monizmit, stema e republikës, drapër e çekan etj.
7. Motivet e gdhendura plotësohen me kornizime lineare apo nga bota bimore. Shpeshherë shoqërohen me mbishkrime me përmbajtje informuese, siç janë koha e ndërtimit dhe të dhëna për pronarin dhe trashëgimtarët e tij (si një certifikatë pronësie e banesës).
8. Në dekoracionet e gdhendura në sipërfaqet e gurta të kullës matjane kanë hyrë dhe motive me ndikime jashtëkrahinore, por në përgjithësi mbisundon simbolika e trashëguar nga ndërtime të mëparshme dhe nga ornamentika e kulturës iliro-arbërore e ardhur në formën e trashëgimisë materiale etj. Ato janë zhvilluar ndër kohëra në bashkëpunim të pandërprerë midis pronarit të banesës dhe mjeshtrave ndërtues. Pronari mbrathte shijet estetike dhe kulturore të zonës ku jetonte dhe këto shije kërkonte të ishin pjesë e dekorimit të banesën së tij.
9. Mjeshtrat që kanë skalitur e zbukuruar banesën popullore në krahinën e Matit, sipas dëshmive të mbledhura dhe rezultateve të studimeve paraardhëse, kanë qenë vendas. Ata kanë trashëguar brez pas brezi këtë zeje, duke sjellë deri në ditët tona. Por nuk duhet harruar edhe kontributi që kanë dhënë në ndërtimin dhe zhvillimin e kësaj banese dhe zbukurimit të saj mjeshtra nga jashtë krahinës, siç janë ata nga Kostenja e Librazhdit, nga fshatrat e Mirditës, nga Tërnova,

- Okshtuni dhe Golloborda (sot pjesë e bashkisë Bulqizë), të cilët janë njohur me emërtimin “mjeshtër të dibranë”, madje, ka pasur edhe disa ustallarë të kombësisë bullgare. Këta e kishin Matin si treg pune në periudhat kur kërkesat e shumta për ndërtime nuk mbulohehin nga ustallarët vendas. Megjithatë, me punën cilësore të tyre, ata u bënë të preferuar nga pronarët dhe njihen jo vetëm për ndërtimet me cilësi, por edhe në realizimin e dekoracioneve me shije artistike.
10. Duke gjurmuar banesën popullore matjane, mjediset jetësore dhe traditën e zbulimores në Mat, kemi konstatuar se ornamentika e përdorur në dekorimin e sipërfaqeve kryesore të kësaj banese ka karakter zbulimor, në të shumtën e rasteve simbolikë të frymëzuar nga flora dhe fauna e mjedisit krahinor, duke ruajtur elementë të trashëguar të heraldikës dhe simbolikës kombëtare, si dhe elementë të huazuar të simbolikës kozmogonike dhe me karakter religjioni të përdorur edhe në popuj të tjerë.
 11. Dekoracionet e realizuara në banesa të ndërtuara gjatë pushtimit otoman janë me pakicë dhe mbase do të shkonin drejt zhdukjes. Por, mendojmë se ajo çka duhet t’iu ketë ardhur në ndihmë mjeshtarve popullorë në kompozimin e elementeve decorative të mëpasëm, qoftë në gur, qoftë në dru, duhet të kenë qenë objektet prej druri të përdorimit të përditshëm, siç ishin lugët, krëhërat, furkat, instrumentat muzikorë etj, ku më së shumti është përdorur stili gjeometrik.
 12. E njëjta gjë bie në sy edhe në huazimin e elementeve dekorues të kostumeve popullore, siç janë simbolet e diellit, vijat e lakuara dhe zikzake, shiritat, kornizat etj. Lëvizja për Rilindje Kombëtare, solli në qendër të vëmendjes përfshirjen në vende kryesore të dekoracioneve simbolin kombëtar: shqiponjën dykrenare. Në ndërtimet e periudhës para Rilindjes, ky simbol mungon, por gjatë shekullit XX ajo fitoi rol të rëndësishëm duke u gdhendur në kulmin e qemerit dhe në shpatullat e portës së kullës, në ballin e oxhakut etj.
 13. Përveç zbulimit të portës, si kult i mikpritjes, rëndësi e veçantë i jepej mjedisit të odës së mikut. Ky mjedis ishte i zbuluar në mënyrën më të mirë të mundshme me objekte prej guri, siç janë oxhakët, fillimisht me shkorsë (me hinkën për të mbledhur tymërat) dhe pastaj me oxhakun “*allafrënga*”, i cili, sipas dëshmimeve lëndore dhe studimore, duket se filloi të aplikohet gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shek. XX dhe deri në mesin e viteve ‘80 të po këtij shekulli.
 14. Në mjedisin e mikpritjes, siç ishte oda e miqve, nuk mungonin as punimet në dru. Sipas nivelit ekonomik, këtu kishte kryesisht dollapë e musandra për mbajtjen e rrobave, trapazanë dhe sergjenë, deri te tavanet e punuar me dërrasa të latuara, madje disa herë edhe me dekoracione gjeometrike e floreale. Por, rëndësi të veçantë në trajtimin artistik të odës së miqve kishte oxhaku.
 15. Te oxhaku me shkorsë kemi shumë pak elemente të gdhendura. Dekorimet këtu realizoheshin më shumë në dollapët anësore dhe kornizën përreth hinkës tymbledhëse. Me futjen në përdorim të modelit frëng, përveç vlerave dobiprurëse të gatimit dhe ngrohjes së banorëve, oxhaku fitoi dhe vlera artistike nëpërmjet të cilave përçonte mesazhe estetike dhe njerëzore. Edhe këtu, gjatë ndërtimeve të shekullit XX, shqiponja është motivi kryesor.
 16. Krahas saj gjejmë simbole të kulteve të diellit, hënës, yjeve, hardhisë dhe forma të shumta nga bimësia dhe gjallesat e mjedisit përreth. Të gjithë këto motive i gjejmë të gershetuar me motivet gjeometrike e floreale. Trashëgimia popullore, ku futen ndërtimet, folklori, veshjet, doket dhe zakonet, shprehin unitetin krahinor të formuar dhe zhvilluar ndër shekuj në bazë të kushteve gjeo-historike, burimeve ekonomike, mardhënieve shoqërore krahinore.
 17. Krahas këtij uniteti, në ndërtimin e banesave dhe në ornamentikën e përdorur, shohim ngjyrimet me bazë zone dhe fshati.
 18. Kjo ka ardhur si rezultat i “duetit” mes mjeshtërve realizues, formimit të tij profesional dhe të pronarit të banesës, botëkuptimit për jetën dhe shijet estetike të tij.

19. Por ajo çka i ka bashkuar në një pikë ka qenë dëshira për pasqyrimin e dekoracioneve të gurta, që venë në pah qëndrimin atdhetar, vlerat trimërore dhe të mikpritjes së banorit të krahinës së Matit, si vazhdim i të njëjtave vlera të kombit shqiptar.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Kurti, Dilaver. “Zbukurimorja e Matit”. Revista “Ylli” Nr. 5, 1986. Tradita e punimit në dru, zbukurimi i odës matjane. Një odë në Lis, Përshkrimi, datimi shek. XIX, stili gjeometrik dhe ai kompozicional i datimit në Mat dhe rreth tij. Me ilustrime.

1. Tirta, Mark. “Etnologjia e shqiptarëve”, “GEER”, Tiranë 2003. “Mitologjia ndër shqiptarë” e botuar nga “Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti e Kulturës Popullore dega e Etnologjisë”. Shtypshkronja “Mësonjtorja” Tiranë 2004.
2. Stadtmüeler, Georg. “*HISTORIJA SHQIPTARE në pikëpamje të kombsis si problemë gjurmimesh*” botim i “Hylli i Dritës”, përkthyer nga Karl Gurakuqi, Shkodër 1942, f. 14, shkruhet: “*Krahina e Matit. Kjo krahinë malsore, e cila asht e rrethueme prej malesh shumë të nalta, mund të kundrohet si një vend i shkëputun, pse i ka të gjitha kushtet natyrore për të ngelë në njenë anë. Dhe me të drejtë kjo ka qenë qysh në kohët e vjetra e deri sot qendra popullore e vërtetë e Shqipnis, qi i ka kundërshtuem ndikimit të huej. Prandej këto kujtime të përgjithëshme na japin apriori dishmin se hapsina jetsore shqiptare e hershme ka qenë krahina e Matit...*”.
3. Thomo, Pirro. “Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë”. Studime Historike Nr. 1, Tiranë 1970, f. 129.
4. Kurti, Dilaver. “Vëzhgime mbi kullën e Matit”. “Bashkimi” 7 shtator 1972. Tipat e kullës: Kullë me një, dy, tre e katër kate. Kullë-kala. Kullë me sharapot. Rruga historike, datimi.
5. Thomo, Pirro. Po aty. “Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë”.
6. Muka, Ali. “Arkitektura e banesës fshatare në Martanesh”, Etnografia Shqiptare Nr. 7. Tiranë 1975 f. 209.
7. Muka, Ali. “Tipare të vendbanimeve dhe të ndërtimeve fshatare në zonën e Shmilit” Kultura Popullore, Tiranë 1987 f. 94.
8. Banesa e Bajram Allushit, Klos Katund, “Monument Kulture” i kategorisë së parë. Shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës 08. 01. 1977.
9. Banesa e Rexhep Lleshit, Klos Katund, “Monument Kulture” i kategorisë së parë. Shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës 08. 01. 1977.
10. Banesa e Abdi (Veli) Domit, Guri i Bardhë, “Monument Kulture” i kategorisë së parë. Shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës 08. 01. 1977.
11. Alcani, Avni. “Librazhdi” Almanak 1, Përgatitur nga Shtëpia e Kulturës dhe Krijimtarisë Popullore dhe Muzeu Historik i rrethit Librazhd. Shtypshkronja “8 Nëntori”, Tiranë 1985, f. 105
12. Kurti, Dilaver. “Zbukurimorja e Matit”, Revista “Ylli” Nr. 5, 1986 (dosja e plotë në arkivin personal, pranë familjes).
13. Tirta, Mark. “Mitologjia ndër shqiptarë”, Mësonjtorja, Tiranë 2004, f. 79.
14. Sadikaj, Hilmi. Mata, Bajram. “Tradita dibrane në gdhendjen e drurit”, ETNOGRAFIA SHQIPTARE Nr. 9 Tiranë 1978. Në faqe 360 thuhet: “*...Përqëndrimi i mjeshtarave të ndërtimit në zonat malore të Dibrës e ka shpjegimin e vet te veçoritë gjeografike, te pasuria me pyje e këtij vendi dhe te faktorë të tjerë tradicionalë të popullsisë së kësaj krahine. Mjaft mjeshttra u përgatitën në vend, por shumë të tjerë u sollën ngë krahinat e brendshme të Arbërisë, kryesisht nga krahina fqinje e Matit. Nga një hulumtim që kemi bërë na rezulton se*

dhjetra fise, që kanë ushtruar brez pas brezi profesionin e mjeshtrit të ndërtimit, kanë ardhur në këto zona nga Mati”.

15. Onuzi, Afërdita. “Vlera Kulturore dhe artistike të ekspozitës Kultura Popullore Shqiptare”, KULTURA POPULLORE Nr. 1, Tiranë 1982, f. 111.
16. Onuzi, Afërdita. “Veshjet popullore në rrethin e Matit”, revista”Emathia” Nr. 2 (10) 2009. f. 44.
17. Kurti, Dilaver. “Legjenda dhe historia e një kulle në Mat”, TRASHËGIME ILIRO-ARBËRORE, botuar nga “DEAS”, Tiranë 1999, f. 289-294.
18. Kurti, Dilaver. “Shqiponja në motivin e gunës shqiptare”, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike 28-30 qershor 1976, Tiranë 1976, f. 585-590.
19. Brahaj, Jaho. “Flamuri i kombit shqiptar origjina, lashtësia”. Botim i Saras. Tiranë 2007. f. 8.
20. Matkovski, Aleksandër. “Stemat shqiptare në të kaluarën”, Gjurmime Albanologjike, Nr. 2. Prishtinë 1969, f.94. (Vep e cituar në “SHQIPONJA NË MOTIVIN E GUNËS SHQIPTARE”, Kurti, Dilaver. Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike 28-30 qershor 1976, Tiranë 1976, f. 585-590.
21. Pulaha, Selami. “Qëndresa e popullit shqiptar gjatë shekujve XVI-XVIII”. Tiranë 1978. Dok. 197, f. 218.
22. Muka, Ali. “Vendi i zjarrit në banesën fshatre të Shqipërisë së Mesme”, Kultura Popullore Nr 2/1984, fq. 29.
23. Muka, Ali. “Vendi i zjarrit në banesën fshatre të Shqipërisë së Mesme”, Kultura Popullore Nr 2/1984, fq. 39.
24. Muka, Ali. Po aty.
Kuçali. Andon, “Përfytyrimet estetike dhe stilistike kombëtare të artit tonë popullor”, “Kultura popullore” Nr. 1, Tiranë 1981. f. 142.
25. Tirta, Mark. Mitologjia ndër shqiptarë” f. 161 dhe “Etnologjia e shqiptarëve” f. 414.
26. Stadtmüeler, Georg. “*HISTORIJIA SHQIPTARE në pikëpamje të kombsis si problemë gjurmimesh*” (Shih shpjegimin Nr. 3 më sipër).
27. Elmaz Meta, lindur më 1949 dhe banues në Burrel. Intervistuar më 26 gusht 2016.
28. Gjeçov, Shtjefën Konstandin. “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Shkodër 1933, f. 66.
29. Tirta, Mark. “Etnologjia e shqiptarëve” GEER Tiranë 2003, f. 336.
30. Krasniqi, Mark. “Mikpritja në traditën shqiptare”. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2005, f. 36.
31. Tirta, Mark. “Panteoni e simbolika” doke e kode në etnokulturën shqiptare. Botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore departamenti i etnologjisë. Tiranë 2007, f. 113.

LITERATURË E SHFRYTËZUAR

1. Albedil, Margarita. “Raskazi po vsemirnoj istorii” Sankt-Peterburg, “Norint” 2001. Botimi në shqip” “Rrëfimi artistik i historisë së njerëzimit-Enciklopedi”, Shtëpia botuese “UEGEN” Tiranë 2008.
2. Alcani, Avni. “Librazhdi” Almanak 1, Përgatitur nga Shtëpia e Kulturës dhe Krijimtarisë Popullore dhe Muzeu Historik i rrethit Librazhd. Shtypshkronja “8 Nëntori”, Tiranë 1985.
3. Brahaj, Jaho. “Flamuri i kombit shqiptar origjina, lashtësia”. Botim i Saras. Tiranë 2007.
4. Fjalor i gjuhës së sotme shqipe. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Tiranë 1981.
5. Gjeçov, Shtjefën Konstandin. “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, Shkodër 1933.
6. Gjergji, Andromaqi. “Mënyra e jetesës në shekujt XIII-XX”, (Përmbledhje studimesh) Tiranë 2002.

7. Gjergji, Andromaqi. “Veshjet popullore në shekuj” (origjina, tipologjia, zhvillimi) Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Instituti i Kulturës Popullore) Tiranë 1988.
8. Krasniqi, Mark. “Gjurmë dhe gjurmime” (Studime etnografike), Shtëpia botuese “8 Nëntori” Tiranë 1982.
9. Krasniqi, Mark. “Mikpritja në traditën shqiptare”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2005.
10. Kuqali, Andon. “Përfytyrimet estetike dhe stilistike kombëtare”, “Kultura popullore” Nr. 1, Tiranë 1981.
11. Kurti, Dilaver. “Zbukurimorja e Matit”. Revista “Ylli” Nr. 5, 1986.
12. Kurti, Dilaver. “Vëzhgime mbi kullën e Matit”. “Bashkimi” 7 shtator 1972 dhe revista “Emathia” Nr. 3 (3) korrik-shtator 2007.
13. Kurti, Dilaver. “Trashëgime iliro-arbërore” Botim i “DEAS”, Tiranë 1999.
14. Kurti, Dilaver. “Shënime etnografike nëpër Mat”, GEER, Tiranë 2004.
15. Kurti, Dilaver. “Folklor nga Mati”, botuar nga “ILAR”, Tiranë 2014.
16. Kurti, Dilaver. “Shqiponja në motivin e gunës shqiptare”, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike 28-30 qershor 1976, Tiranë 1976.
17. Kurti, Dilaver. “Mbi disa trashëgime të kulturës ilire të Matit”. Kumtesë e mbajtur në Sesionin Shkencor “Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve” Tiranë 3-4 mars 1969, nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë.
18. Muka, Ali. “Arkitektura e banesës fshatare në Martanesh”. ETNOGRAFIA SHQIPTARE Nr. 7 Tiranë 1975.
19. Muka, Ali. “Vendi i zjarrit në banesën fshatare të Shqipërisë së Mesme” KULTURA POPULLORE Nr. 2, Tiranë 1984.
20. Onuzi, Afërdita. “Vlera Kulturore dhe artistike të ekspozitës Kultura Popullore Shqiptare”, KULTURA POPULLORE Nr. 1, Tiranë 1982.
21. Revista “Emathia”, revistë historike, kulturore e letrare, organ i shoqatës Historike-Kulturore “Dilaver Kurti” Mat. Formatit A4, 64 faqe brendi bardhë e zi dhe 4 faqe të kapakut me ngjyra. Numri i parë janar-shkurt 2007, numri i fundit nëntor-dhjetor 2016. Shtypi sponsorizohet nga z. Ilir Lleshi, “ILAR” Tiranë.
22. Sadikaj, Hilmi. Mata, Bajram. “Tradita dibrane në gdhendjen e drurit”, ETNOGRAFIA SHQIPTARE Nr. 9 Tiranë 1978.
23. Stadtmüeler, Georg. “Historija shqiptare në pikëpamje të kombsis si problemë gjurmimesh” botim i “Hylli i Dritës”, përkthyer nga Karl Gurakuqi, Shkodër 1942.
24. Strazimiri, Burhan. Thomo, Pirro. “Vështtrim arkitektonik mbi kullën e Matit”, kumtesë e mbajtur në sesionin shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, Tiranë, Dhjetor 1969.
25. Stoli arbërore, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Qendra e Kërkimeve Arkeologjike). Tiranë 1988.
26. Tirta, Mark. “Etnologjia e shqiptarëve”, “GEER”, Tiranë 2003.
27. Tirta, Mark. “Mitologjia ndër shqiptarë” e botuar nga “Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti e Kulturës Popullore dega e Etnologjisë”. Shtypshkronja “Mësonjtorja” Tiranë 2004.
28. Tirta, Mark. “Panteoni e simbolika, doke e kode në etnokulturën shqiptare”, e botuar nga “Akademia e Shkencave e Shqipërisë”, Instituti e Kulturës Popullore. Tiranë 2007.
29. Thomo, Pirro. “Aspekte të njësisë dhe larmisë në arkitekturën tonë popullore”, KULTURA POPULLORE Nr. 1/1981.
30. Thomo, Pirro. “Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë”. Studime Historike, Nr. 1, Tiranë 1970.
31. Ulqini, Kahreman. “Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare”, “Idromeno” Shkodër 2003.

32. Von Hahn, Johan George. “Studime shqiptare”. Botuar nga Instituti i Dialogut & Komunikimit (ish-Shtëpia e Librit dhe Komunikimit), Tiranë. Titulli në origjinal: Dr. jur. Johan Georg Von Hahn “Albanesische studien” Jena, 1854.
33. Ymeri, Aqif. Lasku, Rakip. Kurti, Artan. “Klosi, vështrim gjeohistorik”. “ILAR” Tiranë 2010.